



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal Kačanik

01Nr. 60/01-3910/23
Kaçanik, 27.02.2023

Në bazë të nenit 57.1 dhe 57.2 të Rregullores 01Nr. 7864/08 për Punë të Kuvendit të Komunës e datës 13.11.2008, në çështjen e shqyrtimit të Raportit të Punës së Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2022, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur më datë 27 shkurt 2023, mori këtë:

VENDIM
PËR APROVIMIN E RAPORTIT TË PUNËS I KOMITETIT
PËR POLITIKË DHE FINANCA PËR VITIN 2022

1. Me këtë Vendim, Aprovohet Raporti 01Nr. 60/01-3910/23 - me tekstin e mëtejme, Raport Pune i Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2022.
2. Raporti si në pikën 1 të këtij Vendimi përmban, pikësynimet në lidhje me realizimin e detyrave nga fushë-veprimtaritë që janë në kompetencë të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe nivelin e realizimit të tyre lidhur me aktivitetin e zhvilluar për gjatë vitit 2022.
3. Raporti është përmbledhur në gjithsej 9 faqe dhe i njëjti është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi sipas nenit 17 të Rregullores (MAPL) Nr.01/2017- për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës.

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës; Komiteti për Politikë dhe Financa; Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

I	Data	14.02.23	Vendi	KAÇANIK
	Nj. org.		Numri	Shtojcë
	01		60/01-3910	Y.

**RAPORT PUNE
I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA
PËR VITIN 2022**

Kaçanik, Shkurt 2023

PËRMBAJTJA:

1.HYRJE

2.PËRGJEGJËSITË E KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

3. AKTIVITETI I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

4. ÇËSHTJET E SHQYRTUARA NGA KPF

4.1 Propozim Rregulloret

4.2 Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) e Kaçanikut 2023-2025

4.3 Propozim Buxheti i komunës për vitin 2023 dhe vlerësimet për vitet 2024 -2025

4.4 Raportet finaciare dhe Planet e veprimit

4.5 Propozim Vendimet për çështje financiare

4.6 Propozim Vendime tjera me rëndësi për komunën

4.7 Propozim Vendimet për shpalljen e pronës së paluajtshme me interes të komunës

4.8 Propozim Vendime për formim të komisioneve

4.9 Propozim Vendimet për ndërrim destinimi të tokës bujqësore

4.10 Panet e Punës dhe Raportet e punës

4.11 Çështjet të tjera me rëndësi për komunën

5. SEKTORI I KUVENDIT

6. PËRFUNDIM

1. HYRJJE

Komiteti për Politikë dhe Financa – KPF, është trupë i përhershëm punues i Kuvendit të Komunës është formuar me Vendim të Kuvendit të Komunës 01 Nr. 60/01-38152/21 më datë: 29.12.2021, në përbërje prej 7 anëtarëve.

Komitetit për Politikë dhe Financa ka këtë përbërje:

1. Kemal Murseli	PDK	Kryesues sipas funksionit
2. Kadri Krivenjeva	PDK	anëtar
3. Fitore Vishi	PDK	anëtar
4. Agim Mani	LVV	anëtar
5. Kadrije Lika-Troni	LVV	anëtar
6. Ardita Rrahmani	LDK	anëtar
7. Rabije Sallahi	AAK	anëtar.

Përbërja e Komitetit për Politikë dhe Financa, reflekton përfaqësimin e etnitetëve politike në Kuvendin e Komunës. Me Komitetin për Politikë dhe Financa, udhëheq Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, Kemal Murseli, sipas funksionit që ka. Mandati i KPF-së është i lidhur me mandatin e Kuvendit të Komunës.

2. PËRGJEGJËSITË E KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

Sipas nenit 52.2 të Ligjit Nr.03/L-040 - Për Vetëqeverisje Lokale, KPF-a është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave, duke përfshirë edhe dokumentet e planifikimit strategjik, kornizën vjetore buxhetore afatmesëm, planin vjetor të prokurimit, rregulloren vjetore të tarifave dhe ngarkesave, planin vjetor të punës së auditimit të brendshëm, buxhetin vjetor afatmesëm dhe çdo ndryshim të buxhetit të komunës gjatë vitit fiskal si dhe marrjen e raporteve nga kryetari i komunës dhe dorëzimin e rekomandimeve në kuvendin e komunës.

3. AKTIVITETI I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

Sipas Ligjit Për Vetëqeverisjen Lokale, Statutit të Komunës, Rregullores për punë të Kuvendit të Komunës, KPF-a për gjatë periudhës raportuese është munduar që në suaza të kompetencave të veta t'i realizoj detyrat të cilat janë parashtruar. Veprimtarinë e vet e ka orientuar në fusha të ndryshme të cilat me legjislacionin në fuqi i janë lënë në kompetencë. Aktiviteti i Komitetit për Politikë dhe Financa është zhvilluar në takime të rregullta mujore. Ftesa për mbledhje bashkë me materialin i është dërguar paraprakisht të gjithë anëtarëve të KPF, Ekzekutivit të Komunës, Zyrës së Personelit dhe Zyrës së IT. Gjatë periudhës raportuese ky komitet ka mbajtur gjithsej 11 mbledhje të rregullta. Mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa kanë qenë të suksesshme dhe konstruktive. Angazhimi i anëtarëve të KPF-a ka qenë në nivel të duhur. Prezenca e anëtarëve të këtij komiteti ka qenë e rregullt, me përjashtim të ndonjë mungese shumë të arsyeshme. Nuk ka pasur lëshim apo bojkotim të asnjë mbledhje apo pjesë të mbledhjeve. Në mbledhjet e KPF-së ka mbretëruar një frymë e punës dhe e bashkëpunimit në mes të subjekteve politike të përfaqësuara në këtë komitet. Për të gjitha mbledhjet e KPF-a është mbajtur Procesverbal i cili është bërë transparent në faqen zyrtare të komunës. Në takimet e KPF-së janë shqyrtuar çështje të ndryshme në interes të komunës apo në interes të personave fizik apo juridik dhe të njëjtat iu kanë rekomanduar organit vendimmarrës- Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe vendosje apo sa për njoftim. Për të gjitha çështjet të cilat është dashur të debatohet Kuvendi i Komunës në seancën e vet, kjo trupë punuese paraprakisht i ka shqyrtuar dhe e ka dhënë mendimin e vet. Në këtë drejtim ka shqyrtuar 88 çështje për të cilat ia ka Rekomanduar Kuvendit të Komunës për shqyrtim apo marrjen e vendimit adekuat. Në çdo

mbledhje të KPF-së është aprovuar Procesverbali i mbledhjes së kaluar të KPF-së. Në takimet e kësaj trupe punuese kanë marrë pjesë gati në çdo mbledhje Kryetari i Komunës, në disa mbledhje Nënkryetari i Komunës, ndërkaq kryesisht drejtorët e Drejtorive Komunale, të cilët i kanë arsyetuar çështjet e propozuara sipas fushë veprimtarisë së tyre, pasi që gati çdo çështje ka shqyrtuar KPF, propozimet kanë rrjedhur nga organi ekzekutiv i komunës. Ekzekutivi i komunës në mbledhjet e KPF-a ka dhënë edhe informacione tjera të nevojshme shtesë drejtpërdrejtë në mbledhje.

Bashkëpunimi i KPF-a me stafin ndërkombëtarë gjatë periudhës raportuese ka qenë në nivelin e duhur. I gjithë materiali i mbledhjes i është dërguar OSBE, të cilët kryesisht i kanë monitoruar mbledhjet nga Faruk Dërmaku, I mbledhje është monitoruar nga Rrezart Mehmeti.

Mbledhjet e KPF-së janë mbajtur me dyer të hapura për çdo të interesuar për me i përcjellë mbledhjet, mirëpo pjesëmarrja e qytetarëve, OJQ dhe grupeve tjera të interesit ka qenë minimale. Punën e kësaj trupe punuese e ka përcjellë edhe zyrtari për Informim, dhe për aktivitetin e zhvilluar të KPF-a ka bërë një përmbledhje të punimeve të çdo mbledhje dhe të njëjtin e ka plasuar në faqen zyrtare të komunës dhe në facebookun zyrtar të komunës. Ftesa për mbledhje është publikuar çdo herë në faqen zyrtare dhe në facebookun zyrtar të komunës. Kjo tregon sesa ka qenë transparente kjo trupë punuese ndaj qytetarëve të komunës, OJQ-ve dhe grupeve tjera të interesit për aktivitetin e saj të zhvilluar përgjatë periudhës raportuese.

4. ÇËSHTJET E SHQYRTUARA NGA KPF

Komiteti për Politikë dhe Financa gjatë periudhës raportuese i ka shqyrtuar gjithsej, 101 pikë, përfshirë edhe Procesverbalin e mbledhjes së KPF, i cili ka qenë pikë e parë e rendit të punës në çdo mbledhje, ndërkaq 2 pikë janë kthyer në rishqyrtim propozuesit. Çështjet e shqyrtuara janë materiale të përgatitura nga shërbimet përkatëse profesionale të komunës. Propozim Vendimet kanë qenë të natyrave të ndryshme. Në kuadër të propozim Vendimeve janë shqyrtuar çështje të cilat kanë të bëjnë me rregullativen normative, çështje buxhetore, raporte dhe programe të punës së ekzekutivit të komunës, propozim vendime të ndryshme të shërbimeve përkatëse profesionale, dhe çështje tjera më rëndësi për komunën. Në vazhdim do të i potencojmë çështjet të cilat kanë qenë në shqyrtim të Komitetit për Politikë dhe Financa:

4.1 Propozim Rregulloret

Në kuadër të kësaj sferë bëjnë pjesë aktet normative të cilat kanë qenë në shqyrtim të kësaj trupe punuese. Në këtë drejtim ky Komitet ka shqyrtuar akte normative të propozuara nga shërbimet përkatëse profesionale, dhe atë: Propozim Rregullore për masat dhe veprimet për mbrojtje nga zjarri në objektin e komunës;. Propozim Rregullore për ndryshim plotësimin e Rregullores 01Nr.346-18740/2013 të datës 29.07.2013 për caktimin e tarifave për nisjet e transportit rrugor nga stacioni i autobusëve; Propozim Rregullore Nr.03/2022 për mënyrën dhe kushtet e shfrytëzimit të Palestrës Sportive në Komunën e Kaçanikut; Propozim Rregullore për ndryshim plotësimin e Rregullores 01Nr. 02-60/01-4863/20 datë 06.07.2020 për Taksat Komunale.

Çështjes së akteve normative në përgjithësi kjo trupë punuese i ka kushtuar rëndësi të veçantë. KPF i ka shqyrtuar në detaje të gjitha Rregulloret e sipërpërmendur dhe të njëjtat me Rekomandime të këtij komiteti i janë përcjellë Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim apo në procedurë të mëtutjeshme-debatit publik me qytetarë të komunës.

4.2 Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) e Kaçanikut 2023-2025

Si çdo herë tjetër kur janë shqyrtuar çështjet buxhetore edhe në vitin 2022, KPF-a i ka kushtuar rëndësi të veçantë; Kornizën afatmesme të shpenzimeve të Komunës së Kaçanikut për vitet:

2023-2025. Korniza afatmesme e shpenzimeve është dokument fillestar për hartimin e buxhetit të komunës. Dokumente përcjellëse që i kanë paraprirë hartimit të buxhetit për vitin 2023 janë: Qarkoret e brendshme buxhetore dhe KBAK. Vetëm për Draftin kornizë KPF-a ka debatuar gjerë e gjatë, e ka dhënë mendimin e vet dhe ia ka Rekomanduar Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim dhe lëshimin e dokumentit në procedurë të debatit publik me qytetarë.

4.3 Propozim Buxheti i Komunës për vitin 2023 dhe vlerësimet për vitet 2024 -2025

Në këtë dokument, KPF-a i ka shqyrtuar buxhetin afatmesëm të projektuar të komunës për vitet: 2024-2025, ka aprovuar Propozim Buxhetin e Komunës për vitin 2023 në shumë, 10,674,689.00€, dhe Vlerësimet për vitet 2024-2025, në shumat buxhetore, 11,371,010.00€ dhe 11,823,987.00€ për vitin 2025. Edhe në këtë plan afatmesëm buxhetor, KPF-a ka propozuar me i futur synimet e veta për secilën veprimtari konform Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe Statutit të Komunës, dhe çdo herë duke iu dhënë prioritet Listës së Projekteve Kapitale. Në këtë drejtim ka aprovuar një Listë me 59 Projekte Kapitale të propozuara, duke iu dhënë prioritet atyre projekteve që janë me të nevojshme dhe emergjente për komunitetet në shumën, 2,971,313.00€. Duke marrë për bazë faktin se më buxhetin e ndarë për projekte kapitale, nuk mund të realizohen të gjitha projektet e aprovuara, sepse disa nga projektet kanë hyrë në listë vetëm sa për t'u koduar, mirëpo gjithëherë është menduar në angazhimin e organeve të komunës, në nivelin qendror dhe më gjerë për gjetjen e donacioneve më qëllim që projektet e aprovuara të realizohen. Kontributin e vet për çështjen e buxhetit të komunës, KPF-a e ka dhënë edhe në dëgjime publike të organizuara me qytetarë, ku një dëgjim publik për çështje të buxhetit të komunës është organizuar nga kjo trupë punuese me 16 shtator 2022, për të cilin është mbajtur procesverbal dhe i njëjti është publikuar në faqen zyrtare të komunës, ndërkaq sfidë mbetet pjesëmarrja e vogël e qytetarëve, OJQ-ve dhe grupeve tjera të interesit. Pas vlerësimit të thukët nga KPF-a, Draft Buxheti i Komunës për vitin fiskal 2023 dhe vlerësimet për vitin 2024-2025, i është përcjellë Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

4.4 Raportet financiare dhe Planet e veprimit

Gjatë periudhës raportuese, KPF ka shqyrtuar këto raporte që lidhen me çështjet financiare:

- Raporti Vjetor Financiar për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021;
- Raporti Financiar të Komunës së Kaçanikut, për periudhën: janar-mars, 2022;
- Raporti i realizimit të mjeteve buxhetore për periudhën: janar-qershor, 2022;
- Raporti i realizimit të mjeteve buxhetore për periudhën, janar-shtator 2022;
- Raporti i Auditimit për pasqyrat vjetore financiare të Komunës së Kaçanikut për vitin e përfunduar 31.12.2021 të Zyrës Kombëtare të Auditimit;
- Plani i Veprimit lidhur me Pasqyrat vjetore financiare, për vitin e përfunduar me 31.12.2021;
- Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve në raportin e auditimit të dhënë nga ZKA, për vitin 2021;
- Raporti vjetor lidhur me auditimet e brendshme të kryera dhe aktivitetet e auditimit të brendshëm për vitin 2021;
- Raporti i Auditimit për pasqyrat vjetore financiare të Komunës së Kaçanikut për vitin e përfunduar 2021.

Të çështja e raporteve financiare, KPF-a, në disa sektorë vlerëson se janë përmbushur objektivat në pajtim me planifikimin e të hyrave vetjake komunale, ndërsa në disa sektorë në raport me planifikimin ka qenë më pak i kënaqur dhe këto pakënaqësi kjo trupë punuese i ka shprehur sa herë të ekzekutivi i komunës dhe sugjerimet e KPF-a kanë ndikuar në një angazhim pak më të madh të sektorëve të caktuar që inkasimi i të hyrave vetjake komunale në sektorë të caktuar të shënoj ngritje.

Në Raportet financiare, vlen të cekët se KPF-a ka kërkuar sqarime shtesë të shpenzimeve buxhetore në programe të caktuara buxhetore sa herë që janë shqyrtuar raportet financiare aty ku ka pasur paqartësi, ndërsa për çdo shpenzim që ka menduar se është i madh apo më pak i arsyeshëm në raport më nevojat të tjera, ka dhënë vërejtjet e tjera, ndërkaq i ka mbështetur rekomandimet e Zyrës Kombëtare të Auditorit për zbatimin e rekomandimeve të paraqitura si në raportin e vitit 2021. Në këtë drejtim ka aprovuar Planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve në raportin e auditimit të dhënë nga ZKA, për vitin 2021; Kur jemi të raportet financiare, vlen të përmendet se KPF-a ka kërkuar informacion për procedurat e udhëhequra të tenderimit, ndërkaq kanë sugjeruar Kryetarit të Komunës që Zyra e Prokurimit në bashkëpunim me drejtoritë përkatëse komunale të angazhohen lidhur me projektet për të cilat janë zhvilluar procedurat tenderuese, të realizohen në afatet e përcaktuara kohore, ashtu siç e parasheh Ligji i Prokurimit Publik, në mënyrë që mos të ngelin mjete në suficit buxhetore në suficit. Të gjitha raportet e sipërshënuara, KPF ia ka përcjellë Kuvendit të Komunës në procedurë për shqyrtim.

4.5 Propozim Vendimet për çështje financiare

Propozim Vendimeve për çështje financiare, KPF-a iu ka kushtuar një rëndësi e veçantë, në këtë drejtim në pamundësi të realizimit të disa projekteve kapitale apo çështje të tjera, është intervenuar në mjetet që nuk kanë arritur të realizohet sipas Listës së projekteve kapitale nga vitet paraprake, për t'i bartur në ndonjë projekt tjetër kapital. Në këtë drejtim ka aprovuar Propozim Vendimi për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga vitet paraprake, në buxhetin e komunës 2022, i cili vendim ka ndikuar në ndryshimin e buxhetit të vitit 2022. Ndërkaq, me qëllim që mos të ngelin mjete buxhetore në suficit, KPF ka aprovuar dy Propozim Vendime për rialokimin dhe transferin e mjeteve të projekteve kapitale sipas buxhetit të vitit 2022, Dy (2) Propozim Vendime për transfer të mjeteve sipas buxhetit të vitit 2022 dhe një(1) Propozim Vendim për transferin e mjeteve nga rezerva komunale sipas buxhetit të vitit 2022, Propozim Vendimi për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2023; Propozim Vendimi për lejimin e mjeteve për subvencionim të fermerëve. Për çdo ndryshim buxhetor të propozuar, KPF-a ka kërkuar sqarime të nevojshme nga propozuesi pse ka ardhur deri të ndryshimet buxhetore, e në veçanti ka kërkuar arsye të projektet kapitale që kanë qenë në listë për realizim e nuk janë realizuar në kohën e përcaktuar. KPF, pos tjerash ka kërkuar në vazhdimësi sqarime të nevojshme nga ekzekutivi i komunës se deri ku kanë arritur realizimi i projekteve kapitale. Për të gjitha këto çështje, janë dhënë vërejtjet dhe sugjerimet nga KPF-a dhe të njëjtat i janë Rekomanduar, Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratimin e tyre. Në vazhdim të aktiviteteve, KPF ka shqyrtuar edhe Propozim Vendimi për ndarjen e masës drusore të konfiskuar në vitin 2021, shkollave të komunës. KPF ka shprehur shqetësim për dëmtimin dhe shkatërrimin e pyjeve në masë të madhe, ndërkaq në anën tjetër, masa drusore e konfiskuar është shumë e vogël. Gjithashtu KPF ka pasur në shqyrtim, Propozim Vendimi për realizimin e një vizite studimore e Kuvendit të Komunës Kaçanik në Republikën e Shqipërisë.

4.6 Propozim Vendime tjera me rëndësi për komunën

Propozim vendimet e propozuara kryesisht janë të natyrave të ndryshme me rëndësi për komunën. Në këtë drejtim ka aprovuar, Propozim Vendimi për themelimin e Muzeut të qytetit të Kaçanikut; Propozim Vendim për miratimin e Simbolit Përkujtimor të Gjenocidit në Kosovë; Propozim Vendimi për aprovimin e Listës së veçantë të pronave komunale të cilat planifikohen të jepen në shfrytëzim në vitin 2023; Propozim Vendim Paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim Afatgjatë; Rekomandimi i komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës të PK

Nr.70917093-00156-2, ½, të sipërfaqes 01.00.00ha në ZK Koxhaj, NTP GREEN PRODUCT; Rekomandimi i komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës të PK Nr.70917093-00156-2, ½ të sipërfaqes 01.00.00ha në ZK Koxhaj, XHEMILE VISHI B.I; Rekomandimi i komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës të PK Nr.70917048-01866-0, të sipërfaqes 00.68.68ha në ZK Kaçanik, XHEVDET DERVISHIT. Ndërkaq është njoftuar me një rekomandim të komisionit vlerësues për pronën komunale që nuk ka fitues, në ZK Duraj. Për të gjitha këto çështje, KPF ka diskutuar, e ka dhënë mendimin e vet dhe të njëjtat ia ka ia ka përcjellë Kuvendit të Komunës në procedurë për shqyrtim dhe aprovim apo njoftimi.

4.7 Propozim Vendimet për shpalljen e pronës së paluajtshme me interes të përgjithshëm

Gjatë periudhës raportuese, KPF ka shqyrtuar këto propozim vendime që kanë të bëjnë me shpalljen me interes të përgjithshëm te pronave private:

Propozim Vendimi për shpallje me interes të përgjithshëm publik pjesën e PK Nr. 00433-0 ZK Duraj, për këmbim me pronën komunale, pjesën e PK 00453-0 ZK Duraj; Propozim Vendimi për shpallje me interes të përgjithshëm publik pjesën e PK Nr. 00139-2 ZK Biçec, për këmbim me pronën komunale, pjesën e PK 00162-0, ZK Biçec; Propozim Vendimi për shpallje me interes të përgjithshëm publik, parcelat kadastrale me numrat: 01306-2 dhe 01306-8, ZK Kaçanik i Vjetër, për shfrytëzimin e hapësirave shkollore; Propozim Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik për këmbim të pronës komunale me pronën private ZK Ivajë, parcela me nr. 585-2; Propozim Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik për këmbim të pronës komunale me pronën private ZK Kovaçec, parcela me nr. 174-0; Propozim Vendim për ndryshimin e trasesë rrugore në parcelat kadastrale nr. 1579-2, 1579-3 dhe 3126-0 ZK Begracë; Propozim Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik për këmbim të pronës komunale me pronën private ZK Bob, parcela me nr. 175-0; Propozim Vendimi për shpalljen e interesit publik të pjesëve të PK 01274-3 dhe 01274-4 në ZK Kaçanik, për këmbim me pronën komunale 01274-1 në ZK Kaçanik. Propozim vendimin e fundit KPF e ka tërhequr nga rendi i punës, për arsye se prona e cila kërkohet me u shpallë interes i përgjithshëm është pronë komunale.

4.8 Propozim Vendime për formim të komisioneve

Në këtë drejtim, KPF ka shqyrtuar:

Propozim Vendimi për dhënien në menaxhim të përkohshëm të parkingjeve në pronësi të komunës, Ndërmarrjes publike "Pastërtia" SH.A. Njësia Kaçanik;
Propozim Vendimi për Themelimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për KRM "Pastërtia" – Sh. A. Njësia Kaçanik; Propozim Vendimi për Themelimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për NPK "Stacioni i Autobusëve" Sh. A. Kaçanik;
Propozim Vendimi për formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi-KKSB;
Propozim Vendimi për emërimin e komisionit përzgjedhës për drejtor të institucioneve arsimore; Propozim Vendimi për formimin e komisionit për zgjedhjen e këshillave lokale;
Kërkesa e Asociacionit të Komunave të Kosovës- AKK, për emërimin e delegatëve në Kuvendin e AKK; Propozim Vendim për formimin e Komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës; Propozim Vendim për formimin e Komisionit të ankesave për procedurat e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës; Propozim Vendimi për formimin e Komisionit për hartimin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2023. Për të gjitha këto propozime vendime KPF ka diskutuar, e ka dhënë mendimin e vet dhe të njëjtat ia ka rekomanduar Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

4.9 Propozim vendimet për ndërrim destinimi të tokës bujqësore

KPF e ka pasur një kompetencë për vendosje ndërrimin e destinimit të klasës 5 dhe 6, mirëpo kjo kompetencë iu ka marrë nga KK, me kërkesën e Kryesuesit të KK në pajtim me KPF, kështu që nuk është marrë ndonjë vendim nga kjo trupë punuese i kësaj natyre, ndërkaq janë shqyrtuar këto propozim vendime: Propozim Vendimi Paraprak për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, PK 00824-11 ZK Strazhë, me kulturë Tokë Pyjore- Mal i Klasës 4, me sipërfaqe 637 m², pronë e Kadri (Faik) Lalinovci nga Ferizaj; Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, PK 01402-1 ZK Sopicë, me kulturë Bujqësore Arë e Klasës së 5, me sipërfaqen 3917m², pronë e Ekrem (Ramadan) Hyseni nga Ferizaj, nën qiramarrje 99 vjet; Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, PK 00311-0 ZK Ivajë, me kulturë Bujqësore Livadh i Klasës së 6, në sipërfaqen 300m², pronë e Samedin (Vehbi) Rexha nga Kaçaniku; Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore PK 01123-6 ZK Kaçanik i Vjetër, me kulturë bujqësore Arë e Klasës 6, me sipërfaqe 600 m², pronë e KBI; Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore PK 0001952-0 ZK Kaçanik, me kulturë bujqësore Arë e Klasës 6, me sipërfaqe 600 m², pronë e KBI; Propozim Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik për këmbim të pronës komunale me pronën private ZK Begracë, 17 parcela të evidentuara në emër të N.P.P.T.T.SH. ALK-OIL me nr. të biznesit 70052105; Propozim-Vendimi për ndryshimin e thirrjes, Shkolla e Mesme Profesionale –ShMP “Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka”, në Institucion i Arsimit dhe Aftësimi Profesional - IAAP “Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka”; Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të sipërfaqes 300m² në parcelën kadastrale 00255-3 zona kadastrale Vatë-Dubravë, me kulturë bujqësore Arë e klasës 5, në emër të Xhevhet (Ahmet) Mema nga f. Dubravë; Propozim Vendimi Paraprak për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore në parcelën kadastrale 01208-2, Mal i klasës 3 në sipërfaqe 504m² dhe livadh i klasës 3 në sipërfaqe 1722m² në emër të Nexhmedin (Mustafa) Elezi nga f. Sllatinë; Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të sipërfaqes 300m² në parcelën kadastrale 000129-8 zona kadastrale Bob, në vendin e quajtur “Oborr”, Arë e klasës 6, pronë e Blerim (Ajet) Çaka nga Bobi-Kaçanik; Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të sipërfaqes 350m² në parcelën kadastrale 02302-2 zona kadastrale Kaçanik i Vjetër, Arë e klasës 5, në vendin e quajtur “Shoko bare kalishtë” në emër të Blerim (Qamil) Ilazi nga Kaçaniku i Vjetër, nën qiramarrje 99 vjet; Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të sipërfaqes 300m² në parcelën kadastrale 001334-13 zona kadastrale Kaçanik i Vjetër, Arë e klasës 5, në vendin e quajtur “Perovina”, në emër të Blerim (Qamil) Ilazi nga Kaçaniku i Vjetër; Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të sipërfaqes 300m² në parcelën kadastrale 001334-12 zona kadastrale Kaçanik i Vjetër, Arë e klasës 5, në vendin e quajtur “Perovina”, në emër të Burim (Qamil) Ilazi nga Kaçaniku i Vjetër, ndërkaq është hequr nga rendi i punës Propozim Vendimi Paraprak për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, PK 00443-4 ZK Duraj, me kulturë Pyjore-Mal i Klasës 1, me sipërfaqe 5455m², pronë e Tefik (Metush) Zenuni nga Duraj, për mos kompletim të lëndës. Këtyre çështjeve iu është kushtuar rëndësi e veçantë, është kërkuar sqarim nga drejtoria përkatëse për secilin propozim vendim, dhe të njëjtat i janë rekomanduar Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim. KPF-a sa herë që i adresohen propozim vendime të kësaj natyre, sugjeron ekzekutivitet të komunës që të kenë kujdes për mos cenimin e Planit Zhvillimor të Komunës –PZHK respektivisht hartimin e PZHK të ri sa me parë që është e mundur, në anën tjetër i sugjeron që të ruhet tokat bujqësore, sepse fondi i tokave bujqësore në komunën e Kaçanikut është shumë i vogël.

4.10 Planet e Punës dhe Raportet e Punës

KPF gjatë periudhës raportuese ka shqyrtuar këto plane dhe raporte të punës:

- Plani i punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022;
- Plani i punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2022;
- Raporti i punës së Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara, për vitin 2021;
- Raporti i Ekzekutivit të Komunës për vitin 2021;
- Programi komunal trevjeçar i banimit për vitet 2022-2025;
- Raporti i punës i Shtabit komunal për parandalimin e Covid-19, në komunën e Kaçanikut;
- Plani i punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB), për vitin 2022;
- Plani komunal për integritet 2022-2026;
- Strategjia për Informim dhe Komunikim 2023-2026;
- Plani i Reagimit Emergjent për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në objektin e administratës komunale të komunës së Kaçanikut;
- Raporti i punës së KKSBB për gjashtë mujorin e parë 2022;
- Plani i Veprimit për parandalimin e dhunës në familje, 2023-2025;
- Plani i Veprimit për Transparencë 2023-2026;
- Plani i punës së kuvendit të komunës për vitin 2023;
- Plani komunal për menaxhimin e mbeturinave, 2023-2027;
- Raporti i komisionit për zgjedhjen e këshillave lokale.

Këtyre çështjeve KPF iu ka kushtuar rëndësi të veçantë, ashtu që i ka shqyrtuar në detaje të gjitha raportet dhe planet e punës të theksuara si më lartë ka dhënë vërejtjet dhe sugjerimet e veta dhe të njëjtat ia ka rekomanduar Kuvendit të Komunës në procedurë për shqyrtim dhe aprovim apo sa për njoftim. Të Plani i Veprimit për parandalimin e dhunës në familje, ka pasur kërkesë për një Strehimore për gratë dhe fëmijët që përjetojnë dhunë në familje: Krijimin e barazisë gjinore në Zyrën për barazi gjinore. Kur jemi të barazia gjinore, ka pasur kërkesë në KPF për me debatuar në KK kundër dhunës në baza gjinore, ndërkaq është iniciuar çështja e formimit të grupit të grave asambleiste. Të plani i veprimit për transparencë dhe strategjia për komunikim dhe informim KPF ka kërkuar rritjen e transparencës, duke shtuar numrin e punëtorëve në Zyrën e Informimit. Rëndësi e veçantë e diskutimit, KPF iu ka kushtuar edhe planeve dhe programeve tjera, planit të reagimit emergjent, planin e menaxhimit të mbeturinave, programit trevjeçar të banimit, çështjes së sigurisë, çështjes së Covid-19, planit për integritet si dhe raportit për zgjedhjen e këshillave lokale.

4.11 Çështjet të tjera me rëndësi për komunën

Nga çështje tjera, KPF gjatë periudhës raportuese ka shqyrtuar këto informata:

Informatë e drejtorisë së Arsimit për përfundimin e periudhës të parë të Vitit shkollor, 2021/2022;

Informatë e Zyrës së Personelit për menaxhimin e burimeve njerëzore për periudhën Janar-Dhjetor 2021;

Informatë për fillimin e Vitit të Ri shkollor 2022/2023;

Informatë për përfundimin e Vitit shkollor 2021/2022.

Edhe këtyre çështjeve iu ka kushtuar KPF rëndësi të veçantë, ka kërkuar sqarime shtesë nga organet kompetente lidhur me statistikat e prezantuara në këto informata dhe të njëjtat ia ka adresuar KK në procedurë për shqyrtim. Të Informatat e arsimit ka shprehur shqetësim për numrin e mungesave të arsimtarëve dhe të nxënësve, zvogëlimin e numrit të nxënësve sidomos në shkolla të mesme dhe ka kërkuar gjetjen e formave që numri i nxënësve në këto shkolla mos të zvogëlohet.

5. SEKTORI I KUVENDIT

Punët dhe detyrat e punës së KPF-a përgatiten nga një zyrtar i punësuar në Sektorin e Kuvendit të Komunës dhe asistentes së Kryesuesit të Kuvendit. Me angazhimin e këtyre zyrtarëve, përgatiten mbledhjet e KPF-a, përgatitet materiali i nevojshëm, përpilohet: Procesverbali i mbledhjes dhe Shkresat tjera të dalë nga mbledhjet e kësaj trupe punuese dhe të njëjtat arkivohet për nevojat e Shërbimit Civil të Komunës. Të njëjtat punë këta zyrtarë kryejnë edhe për Kuvendin e Komunës dhe trupat tjerë punuese të KK.

6. PËRFUNDIM

Komiteti për Politikë dhe Financa është i vetëdijshëm se gjatë periudhës raportuese nuk ka qenë në gjendje të realizoj të gjitha synimet e veta në drejtim të zgjedhjes së çështjeve si pasojë e së kaluarës dhe me një buxhet të limituar, por angazhimi i tyre jep shpresë se në një të ardhme të afërt dhe me një angazhim permanent në gjetjen e donacioneve etj. si dhe shqyrtimin e mundësive për shtimin e të hyrave vetjake komunale, gjendja do të përmirësohet. KPF është i mendimit që veprimtarinë e vet në të ardhmen do t'i orientoj në arritjen synimeve në realizimin e projekteve kapitale më rëndësi ekonomike, duke u bazuar në planet zhvillimore dhe realizimin e projekteve kapitale më prioritet sipas Listës së aprovuar për vitin 2023, ndërkaq vlerëson se ka nevojë të bëhet më tepër në këto segmente: Zhvillimin ekonomik të komunës, Shtimin e të hyrave vetjake komunale apo së paku realizimin e atyre që planifikohen, Zbutjen e papunësisë, Ngritjen e mirëqenës sociale, Çështjen e banimit social, Kujdesin primar shëndetësor, Mbrojtjen e ambientit, Ngritjen e cilësisë në arsim, Përmirësimin e infrastrukturës shkollore sidomos të shkollës fillore "Emin Duraku" në Kaçanik - Ndërtimin e objektit të ri shkollor, Zbatimin e rregullave të ndërtimit sipas standardeve, Ofrimin e Shërbimeve publike sa më cilësore, Nevojën për shtimin e subvencioneve dhe transfereve në sektorët: Arsim, Shëndetësi dhe Bujqësi, Përmirësimin e infrastrukturës fizike (rrugë, ujësjellës dhe kanalizim), Ndërtimin e rrugës "Idriz Seferi" në Kaçanik.



Për Komitetin për Politikë dhe Financa
Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli